

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**UJESJELLES KANALIZIME SH.A. SARANDE**

---

ADRESA : Lagja nr 2, Sarande  
Tel/Fax ++ 355 852 2 62 64

Sarande me \_\_\_\_\_

**Specifimet teknike te procedures “Mirembajte e Njesive Operacionale ne I.T.U.N,  
Cuke. Perfshire Pompat, Pajisje, Matriale etj.”**

***1.Informacion mbi stacionet e pompimit, njesit operacionale per sektore te ndryshem trajtimi si dhe  
vendndodhjen e tyrene I.T.U.N.***

Implanti I trajtimit te ujrade te ndotura ndodhet i pozicionuar ne juge-lindje te qytetit te Sarandes, ne fushat e Vurgut. Sic do njesi tjeter operacionale per riqarkullimin, ngriten dhe levisjen e ujit ne hallka te vecanta per te arritur parametrat e kerkuar, dhe impianti i trajtimit te ujrade te ndotur ndertohet nga sisteme te ngritjes mekanike apo sisteme levizese per riqarkullim e ujit te ndoture.

Jane gjithsej 4 stacione kryesore pompimi per levizjen e ujit ne per sektore te ndryshem trajtimi si dhe pompimin e tij ne drejtimi te basenit uje prites me te afert lumi Bistrica. Stacioni Inlet i cili perbehet nga 3 pompa, arine te grumbulloje sasin e nevojshme te ujrade qe vine nga qyteti i Sarandes dhe qyteza e Ksamilit, si dhe e pompon keto ujra te pa trajtuar, per ne procesin e trajtimit paraprak. Stacioni i ndermejetem perbehet nga 3 pompa, dhe arine te grumbulloje sasin e ujrade te cilat kane kaluar proceset e trajtimit primare dhe ate biologjik, duke e pompuar kete sasi uji ne drejtim te stacionit fundore te klorinimit. Stacioni Outlet perbehet nga 3 pompa, te cilat arijne te zhvendosin te gjitha ujrat e gjeneruar nga trajtimi i Impiantit, dhe pompimin e tyre ne drejtim te lumit Bistrica. Stacioni i riqarkullimit te ujrade te drenuar nga depozitimi i llumrave te gjeneruar ne pondet e ajeruara, perbehet nga 2 pompa te cilat pompojne ujin e grumbulluar te drenazhit te vaskave te tharjes se llumit, ne drejtim te kulles shperndarese per pondet e ajeruara. Ne keto stacione, ashtu sic eshte pershkruar edhe ne preventiv, jane te instaluara pompa zhytese (stacione qetsimi) verikale (ne stacione mbeshtetes). Pompat jane te llojeve dhe markave te ndryshme si “FLYGET”. Sistem tjeter me ngritte mekanike eshte dhe sitemi i zhvendosjes se llumrave te cilat gjenerohen ne pondet e ajeruara. Gjithesej kemi tre stacione te zhvendosje se llumrave, nga 1 per secalin ponde, ne te cilat jane instaluar pompa horizontale me boshte me gunga. LLoji I pompave te instaluar ne per keto stacione eshte “BELLIN”.

Per aritjen e parametrave te kerukar te ndotsave qe permbajen ujrat e ndoture, ne Impiant kemi te instaluara dhe njesi te tjera operacionale te cilat ndihmojne proceset e tajtimit te ujrade te ndoture, duke larguar, zhvendosur, ajeruar dhe koaguluar keto ujra, nga ndotesit qe keto ujra permbajne. Per njesite ne fjale, me specifikisht, per modelin dhe teknologjin do te trajtohet ne preventivine hartuar nga dega teknike. Stacionet e pompimit jane relavisht te rind, Impianti ka perfunduar ne vitin 2013. Sigurisht, qe gjate kesaj kohe qe ka qene ne funksionim, nuk eshte aritur te behet nje mirembajtje preventive ne keto sisteme te impiantit, por vetem mirembajtje te zakonshme per nevoja emergjente qe kane lindur gjate funksionimit te tyre. Kjo eshte nje nga arsyet qe per kete perudhe kaq te shkurter, sistemet po degradojne dhe po shfaqin gjithenje e me shume probleme teknike.

## **2.Kategorite e punimeve**

**Punimet qe do te kryhen, per mirembajtjen dhe riparimin e elektropompave, jane dy llojesh;**

**Punime mekanike qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e pompave.**

Me konkretisht, ne keto punime perfshihen;

Çmontimi i pompes nga bazamenti ose nxjerrje nga pusi, transport ne piken e servisit, demontim i vete pompes, riparim ose zevendesim i pjeses se demtuar ( kushinet, bosht, permistop, bokoll, distancator, difuzor, elike, Stator, Rotor etj), montim i pompes, risjelleje ne stacion dhe futje ne bazament .

Pervec ketyre, perfshihen edhe disa punime te tjera te mirembajtjes prventivuese, si grasatime kushinetash ose lubrifikim me vaj, sipas rastit, shtrengime bulonash, etj, e cila do te percaktohet ne preventive sipas manualit te operimit dhe mirembajtjes te njesise.

**Punime elektrike, qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e elektromotoreve.**

Edhe per punimet elektrike, do te ndiqet i njeiti proces pune si per pompat, por per elektromotoret, eshte parashikuuar kryesisht avolzhimi (ripeshtjellimi) i tyre dhe, ne disa raste, edhe zevendesimi i pjeseve te tjera te kembimit, si kushineta, permistopa, boshte etj.

Punimet qe do te kryhen, per mirembajtjen e njesive te sistemeve operacionale , jane dy llojesh:

Punime mekanike qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e gjithe pajisjes ne fjale si :

Ventilatoret, Grilat automatike, Kompresoret e ajerit, Desander, sitemi I zhvendosjes se mberurinave etj.

Si dhe punime elektlike per riparimin dhe mirmajtjen e elektromotoreve te ketyre njesive.

## **3.Preventivi dhe te dhena te tjera teknike**

Ne preventivin e hartuar per realizimin e kesaj procedure prokurimi percaktohen; marka dhe tipi I pompes, njesise operacionale si dhe elektromotorat perkates, numrat e pompave dhe marka e prodhimit per cdo pajisje.

Ne preventiv jane te perfshira edhe punimet shtese si, demontim dhe montim i pajisjes (nxjerrje dhe rifutje ne stacion), transport deri ne piken e servisit dhe risjelleje, per cdo sherbim qe do te kryhet dhe do t'i kete te nevojshme keto punime.

Ne preventiv jane paraqitur punimet dhe pjeset e kembimit, qe mund te nevojiten per nje elektropompe , te cdo marke ose te cdo stacioni pompimi, por Autoriteti Kontraktor, ka te drejte, qe te riparoje me shume se nje pompe te se njejtë marke apo dhe njesi operacional, mjafon qe ky punim te kryhet ne baze se vlerse se ofertuar per riparimin e kesaj pompe dhe vlera totale e punimeve ne asnje rast te mos e kaloje vleren totale te kontrates.

Ne preventive do te percaktojm per cdo njesi qe do te prokurohet, dhe sherbimin perkates preventivues i cili do te jete i percaktuar ne kohe sipas manualit teknik te mirembajtjes. Cmimi per kete sherbim do te vendoset si cmim njesi per per 1 sherbim, dhe do te merret si cmim reference te sherbimeve ditore te realizuara nga shoqeria jone dhe/ose si cmim reference nga mesatarja e ofertave te operatoreve qe sherbejn ne kete sktor te tregut.

Produketet e kerkura ne preventivin e hartuar, duhet te permbushin specifikimet teknike te njesie operacionale ose pajisjes ne fjale, si dhe ne ansje raste nuk perjashtohen produktet **ekuvalente me to** te cilat perbushin specifikimet teknike sipas percaktiveve te llojit dhe tipit te produktit.

Lubrifikantet qe do te perdoren per pompat zhytese te largimit te ujrade te ndotura si dhe per pikat e grasatimit te njsive operacionale, do te jene vajra jo toksike tip Mercury No; 7174,Merkur White oil Pharma 40 ose ekuivalent SAE 10W, SAE 20W dhe graso ESSO UNIRES N3, FAG ARCANOL L40,TEXACO HYTEC EP3/DEA, **ekuvalente me to**. Pragon ose Gançat e vincurave duhet te jene te specifikuar ne lejet e qarkullimit te mjetit, te cilat do bejn zhvendosjen e njesive si dhe ngritjen dhe uljen nga stacioni, .

#### **4.Sqarime dhe detyrime per operatorin ekonomik**

Operatori ekonomik ose ofertuesi, kur te paraqese oferten e tij, duhet te kete parasysh se, cdo ze punimesh , qe do te kryhet, ne rastet kur do te kerkoste zevendesim te pjeseve te demtuara, eshte furnizim dhe vendosje e kesaj pjese, prandaj zeri i **punetorise(hak pune)**,nuk do te paraqitet me vete ne preventiv.

Nga ana tjeter, operatoret ekonomike, qe do te marrin pjese ne konkurrim, duhet t'a kene te qarte se, meqenese kemi te bejme me nje procedure konkurimi, qe do t'i paraprije nje **marreveshjeje kuader**, Autoriteti Kontraktor nuk eshte i detyruar te kryeje cdo punim sipas zerave te preventivit, dhe te paguaje te gjithe vleren limit te kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor do te paguaje operatorin ekonomik, per ato pune, sherbime, riparime, apo zvendesime me pjese te reja qe do te ndodhin faktikisht.

Sherbimi periodik apo profilaktik, do te realizohet nga Operatori cdo periudhe kohe, e cila nise qe nga momenti i neshkrimit te kontrates me Autoritetin Kontraktor, nese nje pajisje kerkon ( Psh. cdo 2 muaj kontroll teknik sipas manualit te mirembajtjes), ateher pajisja sipas percaktiveve ne preventivin e hartuar nga AK, do ti neshtrohet nje kontrolli te imtesishem mekanik dhe elektrik, per ti paraprir dhe parandaluar difektet me te renda te mundeshme te njesise apo pajisjes.

Operatori ekonomik, eshte i detyruar te kryeje me cilesi te larte dhe ne kohe, cdo punim, qe do t'i kerkoste autoriteti kontraktor, sipas zerave te punimeve ne preventiv, brenda vleres limit per cdo ze(njesi),qe operatori ekonomik, ka ofertuar.

Operatori ekonomik, eshte i detyruar qe punimin, qe autoriteti kontraktot do te kerkoj, ta realizoje ne prani te stafit operues te Impiantit si dhe te japi instruksione dhe udhezime per mirembajtjen e njesise apo pajisjes ne fjale.

Per cdo punim(riparim) te kryer, operatori ekonomik duhet te leshoje nje certificate garancie, me afat jo me te vogel se nje vit, nga data e dorezimit perfundimtar te sherbimit. Cdo defekt qe do te ndodhe ne pajisjen e riparuar, brenda periudhes se garancise, do te riparohet nga operatori ekonomik (me vone kontraktuesi), me shpenzimet e tij.

Operatori ekonomik, duhet te marre masa qe, cdo pjese kembimi, te percaktuar ne preventiv, ne baze te markes, tipit, apo numrit te pajisjes, te jete ne gjendje t'a siguroje sa me shpejt te jete e mundeshme. Cilesia e pjeseve te kembimit, te shoqerohet me broshur dhe certifikat produkti, qe per pjeset e montuar ne njesi te kuptohet se jane te satandartit me te lart dhe tregetohen ne Bashkimin European. Mos pasja apo mos sigurimi ne kohe i njeres apo disa pjeseve te kembimit, do te sjelle vonesa te pajustifikueshme per riparimin e aggregatit dhe si rrjedhim edhe te punes normale te njesive operacionale, aq te domosdoshme, te I.T.U.N. Ne raste se ndodhe kjo problematik, do te behet shkak per zgjidhjen e njeanshme te kontrates nga AK .

## **5.Praktika e punimeve**

Sherbimi preventivues ose profilaktik nga OE, do te realizohet sispas percaktimeve ne preventivin e hartuar nga AK. Periudha kohore e kontrollit te njesive apo pajisjeve do respektohet ne menyre rigoroze dhe do te nise qe nga momenti i neshkrimit te kontrates. Gjate ketij sherbimi do te marrin pjese grupi i punes i ngritur nga AK si dhe personeli i specializuar i OE. Per kete sherbimi do te hartoher nje Procesverbal Konstimi ku te shenohen te gjitha te dhenat dhe parametrat e matura apo te diktuara te njesise operacionale apo pajisje. Ky sherbim do te shenohet ne nje regjister kalendrik, nga ku do te filloj koha per parashikimin e konstatimit te dyte si dhe marrjen e masave paraprake. Ne rast se gjate konstimit linde nevoja qe njesia apo pajisja ti neshtrohet nje kontrolli me te imtesishem teknik ne repartin e OE, ateher per paraktin e punes, AK dhe OE do te ndijekin hapat si me poshte per te zgjidhur problemin dhe per te perfunduar procedurat e riparimit.

Operatori ekonomik(kontraktuesi) , do te njoftohet zyrtarisht (bejne perjashtim rastet, qe do te konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor) per defektin dhe pa humbur kohe do te paraqitet me specialistet e tij prane stacionit qe do te kete problem. Pas konstatimit, konfirmimit te defektit, nga te dyja palet, pra specialistet e tij dhe tanet, agregati i demtuar do t'i dorezohet operatorit, me ane te nje akti dorezimi ose flete daljeje provizore.

Operatori ekonomik (me vone kontraktuesi), pasi t'a verifikoje me ne thellesi defektin, duke e zmontuar aggregatin ne piken e tij te servisit, do t'i dergoje Autoritetit Kontraktor, nje raport te hollesishem teknik, ku te pershkruhen ne menyre te detajuar defektet e ndodhura dhe sipas tij, aresyen perse kane ndodhur dhe se bashku me te nje preventive-oferte, per punimet dhe pjeset e kembimit te nevojshme per riparim, duke iu permabjtur rigorozisht, kushteve te parashkruara ne kontrate.

Pasi Autoriteti Kontraktor, t'a kete miratuar kete sherbim, operatori do te vazhdoje pune, per riparimin e defektit, sipas afateve te paracaktuara. Pas perfundimit te riparimit, operatori do te kryeje testimet e nevojshme, te cilat , do t'ia paraqese edhe Autoritetit Kontraktor dhe do t'a montoje pajisjen ne stacion. Agregati ose pajisja do te punoje ne periudhe prove per 72 ore, dhe pas kesaj, do te merret ne dorezim, me nje garanci, te pakten nje vjecare.

Autoriteti kontraktor ne cdo rast do te caktoje nje grupe pune, nga stafi i impiantit apo dega elektromekanike, per te mare pjese gjate sherbimeve preventivuese dhe riparimit, ne menyre qe stafi te njihet me imformacionin dhe udhezimete duhura per mirmbajtjen e pajisjeve

Per te gjitha keto hapa, qe pershkruam me lart, autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik (kontraktuesi) do te plotesojne nje dokumentacion ose regjistri, i cili do te pershkruhet me hollesisht ne kontrate.

*Ne rastet qe, do te konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor,prioritet do t'i jepet zgjidhjes sa me shpejt te problemit, perkunder dokumentimit rigoroz te proceseve qe pershkruam me siper. Por, sidoqoftë, edhe ne keto raste, per aq sa eshte e mundur, do te mbahet nje dokumentacion, i cili te deshmoje punen e kryer.*

## ***6.Cilesia e mallrave te sherbimeve***

Mallrat e shrebimeve duhet te shoqerohen me broshuren perkatese te perkthyer ne shqipe dhe te jene te certifikuar me etiketen “CE” te percaktuar si produkte qe tregetohen ne tregun e Bashkimit European. Mallart duhet te pershtaten me njesite operacionale si dhe te **perm bushin specifikimet teknike** te cdo njesie apo pajisje, sipas markes dhe tipit te pershkruara ne preventivin e hartuar, duke mos perjashtuar ne asnje raste produktet **ekuvalente me to, te cilat rivitalizojn aftesine teknike dhe risin eficencen e energjise te njesise operacionale apo pajisjes ne fjale.**

## ***7.Afati i punimeve***

Afati i kesaj marreveshjeje , do te jete **2 (dy vjecar)**, pra, per dy vite, nga data e lidhjes se kontrates, operatori ekonomik fitues, do te jete pergjegjes per mirembajtjen e njesive operacionale, sipas kushteve te parashkruara ne preventiv dhe specifikime teknike. Ndersa afati i kontratave qe do te lidhen, bazuar ne kete marreveshje, do te vendoset ne varesi te sherbimeve preventivuese, per mirembajtjen e njesive dhe riparimin e defektit(eve) per cdo rast, ne varesi te rendesise teknologjike, qe ka stacioni i pompimit apo njesia operacionale ( motoreduktor apo electromotor), njesi e cila eshte defektuar, njesi te tjera te demetuara apo edhe ne varesi te periudhes kohore ( sezoni veror) ne te cilin munde te ndodh defekti (perben emergence).

## ***Pergatiti***

Inxh. Algert Bajrami

***Miratoi***

Administratori

Inxh. Sheme Lulo